RAPORT PARAPRAK I VLERËSIMIT TE NDIKIMIT NË MJEDIS

TEMA: «VENDEPOZITIM DHERASH TE NDERTIMIT TE STADIUMIT KOMBETAR ARENA(QEMAL STAFA)»

ME VENDODHJE: NE LUNDER, KOMUNA FARKE, QARKU TIRANE

SUBJEKTI «ALB-STAR» SH.P.K.

PERGATI : PER"GREEN BUSINESS ALBANIA"(GBA) MSC. ING.MJEDISI DENISA KOLA

GUSHT 2016

Raporti i Vleresimit paraprak te Ndikimit në Mjedis

"Vendepozitim dherash te ndertimit te Stadiumit Kombetar Arena(Qemal Stafa)"

Vendndodhje në Lunder, Komuna Farke, Qarku Tirane me kordinatat GAUS KRUGE
E =4404922.04
N = 4572886.98

- *Shtojca II pika 11. Projekte te tjera. b) Instalime per asgjesimin e mbetjeve(projekte te cilat nuk perfshihen ne shtojcen 1).*

Hartoi Raportin: Msc. Ing.Mjedisi Denisa KOLA
Rishikoi Raportin: Ekspert Mjedisi Elgerti BIXHA

GBA Studio
Bulevardi Gjergj Fishta,
Pall. e Lanes Nr.1, Tirane, Albania

PERMBAJTJA

KREU I.....5
HYRJE.....5
1.1 Legjislacioni Mjedisor ne Shqiperi……...…7
1.2 Metodika e pergatitjes se studimit te VNM……...…8
1.3 Infomacion mbi shoqerine…….9

KREU II.....9
PERSHKRIMI I PROJEKTIT…….....9
2.1 Qellimi i zhvillimit te projektit……..9
2.2 Metodika e vleresimit……...…10
2.3 Vendodhja e projektit…….....11
2.4 Operacionet e nderhyrjes……..……..12

KREU III.....19
PERSHKRIMI I VENDIT DHE MJEDISIT KU DO ZHVILLOHET AKTIVITETI…….19
3.1 Karakteristikat e zones……..……19
3.1.2 Pershkrimi gjeologo-morfologjik i zones……..……..20
3.1.3 Hidrologjia…….. ……..……...……20
3.1.4 Tokat ……....23
3.1.5 Klima ……..…….....24
3.1.6 Rreshjet…… ……..…….....24
3.1.7 Era… ……....25
3.1.8 Flora dhe habitati i zones ……..……..…….....25
3.1.9 Fauna…… ……..…….....26
3.1.10 Zonat e mbrojtura ……..……....26

KREU IV.....27
PERSHKRIMI TEKNIK I PROJEKTIT…….……27
4.1 Karakteristikat kryesore……...…27
4.2 Perdorimi i tokes, ujerat dhe dherat..……..……27
4.3 Demografia……..……..…..27

KREU V.....31
VLERESIMI I NDIKIMEVE…….……31
5.1 Ndotja e materialit natyror te germuar……..……...……32
5.2 Ndikimet e mundshme ne toke... ……...….32
5.3 Ndikimet ne ujera……...32
5.4 Ndikimet ne Erozioni……..……...….32
5.5 Ndikimet ne ajer……..33
5.6 Ndikimet ne biodiversitet……33
5.7 Ndikimet e mundshme ne humbjen e tokes……...….33

5.8 Ndikimet mbi trashegimine kulturore……33
5.9 Ndikimet me natyre nderkufitare……...33

KREU VI.....34
MASAT PER ELEMINIMIN/ ZVOGELIMIN E NDIKIMEVE……..……34
6.1 Masat ndaj ndotjes se materialit……..…….....34
6.2 Masat per ndikimet ne toke…….…34
6.3 Masat per uljen ne minimum ndikimeve ne uje……..…34
6.4 Masat nga erozioni……...……....35
6.5 Masat per cilesine e ajerit……...….35
6.6 Masat zbutese ne biodiversitet……..……..36
6.7 Masat ne humbjen e tokes dhe pejsazh……..……..36

KREU VII.....36
PLANI I MENAXHIMIT TE MBETJEVE……..36
PLANI IMENAXHIMIT DHE MONITORIMIT TE MJEDISIT 36
7.1 Plani i menaxhimit 37
7.2 Plani i monitorimit te mjedisit 38
7.3 Auditimi mjedisor 41

KREUVIII.....41
KONKLUZIONE ……..……..…41
8.1 Konkluzione 41

KAPITULLI I

HYRJE

Raporti synon te jape nje informacion te detajuar dhe te besueshem lidhur me ndikimin mjedisor te projektit te propozuar ne perdorimin e tokes, efektet lidhur me ndikimet ne floren, faunen, burimet e ujit, emetimin e gazeve sere ne atmosfere, shkarkimet ne toke, uje, ndotjen akustike, si dhe çdo ndikim social ekonomik ne punesimin lokal, permiresimin e infrastructures dhe ndikimeve te tjera te rendesishme mjedisore ose sociale, perfshin gjithashtu parashikimin dhe planifikimin e masave zbutese te ndikimeve te projektit ne mjedisin fizik dhe social me qellim permisimin e cilesise dhe qendrushmerise se mjedisit nepermjet :

-Marrjes ne konsiderate te çeshtjeve te mjedisit ne fazen e pergatitjes se projektit.
-Shqyrtimit te alternativave te ndryshme brenda projektit.
-Te jape nje gjendje sa me reale, nga pikepamja e ndikimit te aktivitetit mbi mjedisin human.
-Analizen e faktoreve pozitive e negative mjedisore, percaktimin e masave zbutese per reduktimin e ndikimeve negative.
-Nxjerrjes ne dukje dhe vlersimin cilesor te ndikimeve ne mjedis te projektit.
-Propozime te masave zbutese te ndikimit ne projekt.

Mjedisi dhe mbrojtja e tij nuk eshte i rendesishem vetem per njerezit por eshte thelbesor dhe i nevojshem per te gjitha qeniet ne toke. Njerezit duhet te kuptojne se si perdorimi i burimeve mjedisore dhe perfitimet qe vijne nga ato te mos demtohen por te jete e mundur te perfitohet sot dhe ne te ardhmen. Ndotja e mjedisit nenkupton shkarkimet e cdo lloj mbetje nga pjese te materialeve te ndryshme ne uje , toke, ajer e cila shkakton ose mund te shkaktoje probleme mjedisore te perkoheshme ose te perhershme ne balancen ekologjike te tokes. Se bashku me zhvillimin e madh qe eshte bere ne industri te ndryshme ne menyre te ngjashme me te njejten shpejtesi eshte rritur edhe sasia e mbetjeve nga perdorimi i te mirave materiale. Mbetjet industriale dhe ato urbane te patrajtuara , emetimet e gazeve te demshem ne atmosfere , perdorimi i kimikateve te reja pa marre parasysh demet qe mund ti sjellin mjedisit kane sjelle problemet mjedisore me te cilat ne perballemi ne ditet e sotme. Ndaj eshte e nevojshme qe shoqeria te ndergjegjesohet per ta mbajtur sa me paster mjedisin ku jetojme duke marre masat e duhura per trajtimin e mbetjeve si dhe emetimin e gazeve te demshem ne atmosfere qe gjenerohen nga zhvillimi i aktiviteteve te ndryshme. Ne menyre qe te shmangen keto probleme njerezimi duhet te mesoj se si te menaxhohen burimet natyrore ne menyre te qendrueshme. Pra zhvillimi i qendrueshem i burimeve natyrore nuk eshte gje tjeter vecse perdorimi i tyre ne menyre ekonomike nga brezat e sotem per ti len keto burime te perdoren edhe nga brezat qe do te vijne. Qendrueshmeria perfshin menaxhimin e gjithe perberesve dhe burimeve natyrore e njerezore me qellim qe te pasurohen me kalimin e kohes dhe te sigurohet nje mireqenie per te gjithe. Zhvillimi i qendrueshem nuk i pranon politikat te cilat cojne ne uljen e bazes prodhuese dhe lene gjeneratat e ardhshme me prespektiva me te ulta (te varfera) dhe/ose rreziqe me te medha se te tonat. Teknologjite qe kontribuojne ne zhvillimin e qendrueshem perfshijne kontrollin e ndotjes, prodhimin e energjise se ricklueshme, rikuperim burimesh dhe riciklim, menaxhim burimesh dhe kerkime shkencore. Vitet e fundit industria e ndertimit ne vendin tone ka patur nje zhvillim te madh. Kompanite e ndertimit ne vendin tone jane nder subjektet e biznesit me me teper fitim dhe qe zhvillojne

nje aktivitet te madh ekonomik. Vet sektori i ndertimit ne vendin tone eshte nje nga shtyllat e ekonomise shqiptare dhe numeron nje numer te konsiderueshm te punesuarish, ne nje kohe qe kompanite e ndertimit sot jane nder taksa-paguesit me te medhenj te arkes se shtetit.
Aktiviteti te cilin ne do te trajtojme eshte ” *Vendepozitim dherash te ndertimit te Stadiumit Kombetar Arena(Qemal Stafa)*”.
Pra impakti mjedisor i referohet ndryshimit te mjedisit natyror nga aktiviteti njerezor.
Kemi dy tipe te impaktit mjedisor:
- Shterimi i burimeve
- Ndotja

Ne menyre qe te shmangen keto probleme njerezimi duhet te mesoj se si te menaxhohen burimet natyrore ne menyre te qendrueshme.

SHPJEGIMI I AKRONIMEVE
VNM- Vleresimi i Ndikimit ne Mjedis
VKM- Vendim i Keshillit te Ministrave
MM- Ministria e Mjedisit
AKM- Agjensia Kombetare e Mjedisit
NJQV – Njesi e Qeverisjes Vendore
QKB- Qendra Kombetare e Biznesit
DRM- Drejtoria Rajonale e Mjedisit

Pasqyra e te dhënave kryesore
Projekti: *Vendepozitim dherash te ndertimit te Stadiumit Kombetar Arena(Qemal Stafa)*.
Me vendndodhje: Ne Lunder, Komuna Farke, Qarku Tirane
Kompania zhvilluese: “ALB-STAR” shpk
Pergatiti raportin e VNM-se: “GBA” Studio sh.p.k

1.1 Legjislacioni Mjedisor ne Shqiperi

Ne Shqiperi fillesat e legjislacionit mjedisor shfaqen ne vitin 1993 , vit ne te cilin u hartua plani i pare i veprimit ne fushen mjedisore, qe perben dokumentin e pare zyrtar shqiptar mbi politikat mjedisore ne vend. Ky plan veprimi kombetar parashikonte se qeveria duhet te krijoje kuadrin ligjor , ekonomik dhe institucional per zgjidhjen e ceshtjeve mjedisore. Periudhen nga ky vit deri ne miratimin e Kushtetutes ne vitin 1998 mund ta konsiderojme si etapen e pare te zhvillimit te se drejtes shqiptare te mjedisit. Mbas vitit 1998 e ne vijim eshte periudha e dyte e zhvillimit te se drejtes shqiptare te mjedisit, e cila ka si tipar kryesor prirjen e perafrimit me legjislacionin e Bashkimit Europian per mjedisin. Kuadri ligjor mjedisor shqiptar eshte ne persosje dhe pasurim te vazhdueshem dhe zhvillimi i tij nuk i eshte len rastesis, por ka si model dhe drejtues legjislacionin europian te mjedisit. Legjislacioni mjedisor eshte hartuar per te mbrojtur dhe parandaluar ndotjen dhe demtimin e komponenteve te vecante dhe te rendesishem te mjedisit nga faktore te ndryshem, njerezore dhe natyrore. Nder ligjet me kryesore ne lidhje me kete projekt, mund te permendim:

- **Ligji nr.10 440 date 07.07.2011 " Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis "**
- **Ligji nr. 10 448 date 14.07.2011 "Per Lejet e Mjedisit"**
- **Ligji nr. 10 463 date 22.09.2011 "Per menaxhimin e integruar te mbetjeve"**
- **Ligji Nr.10 431,date 09.06.2011 " Per Mbrojtjen e Mjedisit"**
- **Ligji nr. 8897 dt. 16.05.2002 "Per mbrojtjen e ajrit nga ndotja" i ndryshuar.**
- **Ligji Nr.9587, datë 20.07.2006, "Për mbrojtjen e biodiversitetit"**
- **Vendim Nr. 123, datë 17.02.2011 "Per menaxhimin e zhurmave"**
- **Vendim Nr. 313, datë 09.05.2012 "Për rregulloren e mbrojtjes se publikut nga shkarkimet ne mjedis.**
- **Vendim Nr. 247, datë 30.4.2014 "Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore"**
- **Vendim Nr. 686, datë 29.07.2015 "Për zhvillimin e procedures se VNM-se"**
- **Vendim Nr. 177, datë 31.03.2005 "Për normat e lejuara te shkarkimeve te lengeta dhe kriteret e zonimit te mjediseve ujore pritese"**
- **Udhezimin nr 8 dt. 27.11.2007 "Per nivelin kufi te zhurmave ne mjedise te caktuara"**
- **Urdhrin e ministrit nr. 146 dt. 8.5.2007 "Per miratimin e listes se kuqe te flores dhe faunes"**

Aktiviteti i ketij subjektit mbeshtetet ne parimet baze te mbrojtjes se mjedisit:

a)Parimin e zhvillimit te qendrueshem duke lejuar zhvillimin e ketij aktiviteti ne perputhje me aktivitetet e tjera te kesaj zone .
b)Parimin e kujdesit per te pakesuar rrezikun mjedisor, per te parandaluar e minimizuar ne kohen e duhur çdo demtim te mundshem te mjedisit.
c)Parimin e parandalimit duke miratuar variantin me te mire,qe ne fazen e vendimmarrjes per te shmangur ndikime te demshme te veprimtarise ne mjedis.

ç).Parimi “ndotesi paguan” qe nenkupton koston qe paguan ndotesi per permiresimin e nje mjedisi te ndotur dhe per kthimin e tij ne gjendje te pranueshme,d.m.th pagesen e takses vendore per pastrimin e ambjentit.
d)Parimi i pergjegjesise ligjore.
e)Parimi i mbrojtjes ne shkalle te larte.
f)Parimi i integrimit te mbrojtjes se mjedisit ne politikat sektoriale.
g)Parimi i ndergjegjesimit dhe i pjesmarrjes se publikut ne vendimmarrjen mjedisore.

1.2 Metodika e Studimit te VNM-se

Vleresimi i ndikimit ne mjedis eshte nje proces qe siguron qe ndikime mjedisore te rendesishme, sinjifikante jane vleresuar dhe marre ne konsiderate ne menyre te kenaqshme ne planifikim, projektim, zbatim te aktivitetit qe do te zhvillohet.

Ndikimi – efekti i zhvillimit te aktivitetit ne mjedis
Vleresimi – analiza qe i behet aktivitetit per evidentimin e ndikimeve negative dhe pozitive
Mjedisi – elementet abiotike (kushtet fiziko- kimike te mjedisit) te kombinuara me elementet biotike (qeniet e gjalle te mjedisit).

Mjedisi fizik perbehet nga :

- qeniet e gjalla (flora , fauna)
- pjesa jo e gjalle (toke, ajer, uje)
- peisazhe (ndikimi vizuale)
- pasurit materiale
- pasuri kulturore (interes historik, turizem)

Mjedisi shoqeror ndahet ne :

- personal
- nderpersonal
- institucional (shendet, ekonomi, etj)

Per te ber nje vleresim sa me te sakte te ndikimeve ne mjedis nga zhvillimi i aktivitetit, studimi i vleresimit te ndikimit ne mjedis u orientua nga rendesia dhe madhesia e projektit, vendi ku ai ndodhet, pasurite natyrore dhe humane te zones si dhe vlerat e veçanta te tyre ne indentifikimin e ndikimeve negative dhe pozitive, marrja e masave zbutese per eleminimin, zvogelimin e ndikimeve duke patur parasysh edhe ruajtjen e interesave ekonomike te investitorit.

Studimi strukturohet ne kater faza kryesore :

1.Ngritja e objektivave orientuese te V.N.M.
2.Shqyrtimi i materialeve teknike.

3.Verifikimi ne terren i te dhenave ekzistuese dhe mbledhja e te dhenave te mundshme biofizike dhe humane.
4.Hartimi i raportit te vleresimit te ndikimet ne mjedis sipas legjislacionit mjedisor.

Ky studim ka per qellim te jap konsideratat mjedisore te projektit te propozuar ne menyre qe te orientoje institucionet dhe organet vendim marrese ne dhenien e miratimin e lejes se kryerjes te aktivitetit.

Per te arritur nje vleresim sa me real te territorit duhet te analizojme situaten duke evidentuar pikat kyce si:

- Legjislacioni mjedisor
- Madhesia e projektit
- Pozicioni gjeografik ku do te zhvillohet
- Ndikimet e mundshme ne mjedis si pasoje e zhvillimit te aktivitetit
- Te dhenat gjeologjike te zones
- Te dhenat mbi floren dhe faunen e zones
- Historia arkeologjike dhe monumentet e kultures
- Popullsia , gjendja ekzistuese dhe e ndryshimeve

1.3 Informacion mbi shoqerine

Subjekti i cili do te zhvilloj aktivitetin ” *Vendepozitim dherash te ndertimit te Stadiumit Kombetar Arena(Qemal Stafa)*” eshte ***ALB-STAR sh.p.k*** i regjistruar prane Qendres Kombetare te Biznesit me date 15-02-1995 dhe themeluar me date 15-02-1995 me numer NIPTI **J62903512W** , forma ligjore **SHPK.** Subjekti zhvillon kete aktivitet per *Vendepozitim dherash te ndertimit te Stadiumit Kombetar Arena(Qemal Stafa)*, duke u mbeshtetur ne rendesine e hartimit te studimeve urbanistike rajonale dhe mjedisore me standarte bashkohore, per permbushjen e kerkesave te investitorit per projektin qe do te realizohet.

KAPITULLI II

PERSHKRIMI I PROJEKTIT DHE VEPRIMTARISE

2.1 Qellimi i zhvillimit te projektit

Qellimi i ketij aktiviteti eshte Depozitimi dhe sistemimi i dherave qe do te dalin nga germimi per ndertimin e Stadiumit te Ri Kombetare arena (Qemal Stafa). Te gjitha proceset e punes qe nga sigurimi i lendeve te para e deri ne perfundim do te zbatohen konform akteve ligjore ne fuqi per mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qendrueshem te tij.

2.2 Metodologjia e vleresimit

Materiali natyral i germuar ne ambjentet e Stadiumit Kombetar Arena (Qemal Stafa) do te depozitohet ne token are me siperfaqe 3400 m^2 e me vendndodhje ne Lunder, e regjistruar ne Zyren e Regjistrimit te Pasurive te Paluajtshme Tirane me Nr. pasurie 734/1/6, vol.2, faqe.170, Zona Kadastrale 2529. Keto dhera kane te njejten tipologji dhe karakteristika te dherave dhe nenshtresat e tokes nuk kane kane rrezik per ndotje apo ndryshime te mjedisit me kimikate te rrezikshme dhe substance te tjera lidhur me to.
Depozitimi i ketyre dherave ne token are me vendndodhje ne Lunder konsiston ne keto faktore:

1. Stabilitetin gjeologjik te vendepozitimit,
2. Speciet biologjike te mbrojtura, habitatet e zones,
3. Dukurine e rastisjes se puseve te ujit apo burimeve ujore,
4. Dukurine e rastisjes se monomenteve te cultures apo natyres,
5. Perdorimi i tokes,
6. Afersine me shtepite e banuara apo inpakte dhe shqetesime te lidhura me to,
7. Impakte potenciale ne afersi te sitit apo pergjate transportit,
8. Efektet e mundshme te ndonje deshtimi ne stabilitet, shkarja e tokes dhe erozioni.

Ligji Nr.10463 date 22.09.2011 “Per menaxhimin e intergruar te mbetjeve” i cili ka per qellim te mbroje mjedisin dhe shendetin e njeriut si dhe te siguroje administrimin e duhur mjedisor te mbetjeve nepermjet menaxhimit te integruar te tyre.
Bazuar ne nenin 4 pika c, tokat qe nuk jane te ndotura dhe materialet e tjera natyrore, te germuara si pasoje e veprimtarrive te ndertimit, ne rastet kur eshte e sigurt qe materiali do te perdoret per qellime ndertimi ne gjendjen e tij natyreore ne territorin nga ku eshte germuar.
Gjithashtu neni6, pika 1, percaktimi i perparesive ne ligje, strategji, plane dhe programe te menaxhimit te intergruar te mbetjeve te trasheguara apo te atyre qe krijohen behet duke pasur parasysh hierarkine e meposhtme:

1. parandalimi i mbetjeve;
2. pergatitjen per riperdorim;
3. riciklimin;
4. asgjesimin;
5. rikuperime te tjera.

Duke qene para fakteve qe Qeveria Shqipetare nuk disponon landfille te ketyre mbetjeve, dhe Pushteti Vendor nuk mund te percaktoje vend per riperdorim, mbetet vetem alternative e asgjesimit te ketyre mbetjeve me ane te operacionit te depozitimit te perhershem.
Depozitimi duhet te behet sipas rregullave te percaktuara ne VKM Nr. 575, date 24.06.2015 “Per miratimin e kerkesave per menaxhimin e mbetjeve”.

Klasifikimi i mbetjeve, kuadri ligjor dhe lloj i mbetjes

Materiali i cili do te depozitohet ne kete vendepozitim perbehet nga;
Toke natyrale, gure, mase shkembore dhe humus. Bazuar ne VKM Nr. 99/2005 “Katalogu Shqipetare i Mbetjeve” keto material perfshihen ne kategorine e KODIT: **17 05** Dhera (duke

perfshire dhera nga toka te kontaminuara, gure dhe balta te tjera) dhe nenkategorine e ketij KODI **17 05 04** : dhera dhe gure, te tjera nga ato te oermendura ne 17 05 03.

2.3 Vendodhja e projektit

Vendepozitimi i dherave ne Farke ka nje siperfaqe 3400 m^2 .Terreni i projektuar per vendepozitim mbetjesh dhera dhe inerte te gjeneruara nga ndertimi i Stadiumit Kombetare Arena (Qemal Stafa). Vendepozitimi ka formuar nje siperfaqe te rrafshet dhe te sheshte ne te gjithe siperfaqen e tij dhe ne momentin e inspektimit nuk kishte bimesi.
Vendepozitimi kufizohet :
-ne veri me toke are
- ne lindje me toke are
-ne jug me toke are
-ne perendim me perrua

Me poshte ilustrohet vendodhja e vendepozitimit

Pamje nga Google Earth

Kordinatat *GAUS KRUGE* te ketij vendepozitimi jane:

4404922.04E
4572886.98N

Karakteristikat e ketij vendepozitimi jane:

- Volumi max i projektuar i dherave eshte afersishte 33.490 m^3

- Siperfaqja e tokes per vedepozitim eshte 3400 m^2
- Lartesia mesatare e mbushjes eshte 9.85 m

2.4 Operacionet e nderhyrjes

Operacionet e depozitimit duhet te fuqizojne maksimalisht mbulimin e tokes dhe te siguroje kontroll te rrepte te cilesise se materialeve qe do te depozitohen ne te para se te hidhen ne deponine. Menaxhimi i materialit natyrore te gerrmuar do te kryhet ne perputhje me: idetifikojme efektet e mundshme ne Mjedis, si dhe marrja e masave te domosdoshme per minimizimin dhe parandalimin e efekteve te krijuara ne mjedis nga zhvillimi i projektit "Vendepozitim dherash". Rehabilitimi i zones perreth aktivitetit, si dhe te lihen detyra dhe projekte per investitorin ne sherbim te komunitetit dhe me gjer.
Objektivat e shoqerise jane:

- Mundesine e riperdorimit ose riciklimit: kur eshte e mundur, mbeturinat do te ndahen ne menyre rigoroze per te maksimizuar riperdorimin e materialeve te pershtatshme.
- Riperdorimi i nje pjese te tokes ose dheut per rehabilitim, materiali shtrese i punueshem do te riperdoret per pjesen e siperme te vedepozitimit e cila do te mbushet me dhe per te be rte mundur mbjelljen e saj.
- Depozitimin perfundimtar te inerte te perfshira ne materialin e gerrmuar, i perbere nga material te papershtatshme dhe te perdorur, te gjeneruara gjate pergatitjes dhe ndertimit te Stadiumit Kombetare Arena (Qemal Stafa).
- Nuk duhet te perdoren material natyrale te gjeneruara nga germimet te kontaminuara, ato duhet te evidentohen dhe te hidhen ne vende te caktuara ose te riperdoren gjate ndertimit raste te tilla perfshijne cdo ndotje nga rrjedhjet aksidentale te automjeteve dhe makineri lubrifikante te karburanteve etj.
- Asnje lloj tjeter te mbeturinave ne vend do te perzihen dhe te hidhen ne vendepozitimin e dherave, te tilla si plastike, goma te perdorura etj.

Operacionet kryesore te depozitimit te mbetjeve dhera jane:

- Pergatitja e vendepozitimit
- Kontrolli i cilesise se mbeturinave natyrore te gjeneruara nga germimet dhe ndarja e deferencimi i tyre
- Transporti I materialit natyrore per tu depozituar
- Punime shkarkim, levizje dhe ngjeshje ne vendepozitim
- Rehabilitim dhe perforcim i vendepozitimit
- Monitorimi i qendrueshmerise se skarpatave dhe rehabilitimit

Udhezime te pergjithshme per operacionet e vendepozitimit te mbetjeve

Pergatitja e vendepozitimit

Perpara fillimit te procesit te vendepozitimit procedohet me ooperacione dhe pune pergatitore si:

- Levizja e shtreses se siperme te tokes
- Heqja e vegjitacionit dhe stabilizimi i shtreses se dheut dhe nese duhet te ndertohen edhe barrier inxhinierike me dhe ose me massive guri ne seksione tel gabiani.
- Subjekti ndertues duhet te siguroje levizjen e sistemit drenues, kolektoreve, rrjedhave ujore ose te realizoje zhvendosjen e tyre me ane te tubacioneve.

Kontrolli i tokes natyrore te germuar perpara depozitimit

Materiali i germuar permban fraksione si shtrese e punueshme toke, prerje e vegjetacionit dhe material shkembore. Ne menyre qe te reduktohet volume i depozitimit dhe te rrisim kapacitetin e mbulimit te tokes, duhet ti nenshtrohemi nje procesi diferencimi. Qellimi i ketij procesi do te jete te diferencohet toke natyroree germuar e cila do ten a vije ne ndihme ne procesin e shtresezimit te siperm te vendepozitimit dhe rehabilitimin e saj. Germimet paraprake jane te nevojshme per te siguruar qe asnje ndotje te kete rezultuarne zonen e germimit nje inspektim te dyte visual do te behet gjate fazes se asgjesimit/depozitimit. Nese verehet nje ndotje natyrore te ardhur nga germimet duhet te merren masa per ti nxjerre keto volume nga ky site nepermjet kafazeve perkates dhe te transportohen per trajtimin perkates.
E njejta praktike duhet te ndiqet edhe per mbetje te tjera sic mund te jene plastika, goma te perdorura, kallcuk, etj. Makinerite e germimit dhe punet e lidhura me kete process duhet te inspektohen per mirembajtjen dhe mirefunksionimin e tyre per te shmangur derdhjet aksidentale ne mjedis.

Transporti dhe menaxhimi i materialit te germuar

Pas seleksionimit/ deferencimit te materialit te germuar, kjo sasi mbetjeje do te transportohet dhe menaxhohet ne vendepozitimin si vijon:

- **Shtresa e siperme e tokes:** shtresa e siperme e tokes do te ruhet ne vend te perkohshem depozitimi dhe do te perdoret me vone per qellime te zevendesimit te vegjetacionit ne shpate gjate fazes perfundimtare te rehabilitimit. Eshte e nevojshme te kryhet ndarja e shkembinjeve ranore te vecante nga shtrese e punueshme e tokes. Shtresa e punueshme te ruhet ne zonen e caktuar ne pirgje jo me te medha se 1.5 m ne lartesi.
- **Material per te depozituar:** kjo pjese do te hidhet ne vendin e zgjedhur Brenda vendepozitimit dhe me pas do te zhvillohen operacionet e shtyrjes dhe nivelimit te ketyre voklumeve te dherave. Ne menyre per te kontrolluar pluhurin, vendi do te laget disa here ne dite.
- **Materiali per tu riperdorur:** mbeturinat dhe materiale te tjera te buta te pershtatshme, do te grimcohen, trajtohen dhe pas testimit dhe te inspektimit nga kompania do te riperdoren ne aktivitetet e ndertimit.

Stabilizimi i materialit te depozituar

Punimet e stabilizimit/nivelimit dhe ngjeshjes se dherave, duhet te kryhen ne vend dhe Brenda territorit te zones se percaktuar per vendepozitim. Materiali natyror qe do te depozitohet duhet te ngjishet dhe te rafshohet, ne menyre qe te drenoje ujerat e shiut, dhe per te siguruar stabilitet afatgjate dhe mbrojtjen nga agjentet natyrore si era, erozioni dhe uje.
Te gjithe punimet e nevojshme duhet te projektohen dhe zbatohen nga kontraktori/subjekti ndertues dhe te supervizohen nga supervizori. Raporti i mbylljes dhe rehabilitimit duhet te dokumendohen ne dosjet e projektit.
Duhet te realizihet me domosdoshmeri stabilizimi i shpateve ne menyre qe te kontrollohet dhe shmanget erozioni dhe rreshkitja e dherave.
Per te siguruar qendrueshmerine e tij pas mbylljes, mund te jete e nevojshme per te shtuar nje shtrese organike mbi siperfaqen e depozitimit ne fund te procesit, te pershtatshme per bimesine dhe mbjelljen e faqes. Shtresa e punueshme duhet te ruhet menjane dhe te perdoret per rivendosjen e shtreses perfundimtare te siperfaqes.

Rehabilitimi i vendepozitimit

Ne menyre qe te sigurohet qendrueshmeria dhe stabiliteti i sipefaqeve duhet tem billet vegjetacion i zones. Ne kete faze do te kryhet nje plan paraprak rehabilitimi. Kompania ndertuese si dhe ne perputhje me kerkesat e vete pronareve te tokes. Nese biet dakort me pronaret e tokes, rekomandohet mbjellja e bimesise autoktone te kesaj zone Brenda kesaj siperfaqeje.
Punimet per mbylljen e vendepozitimit dhe rehabilitimit te saj duhet te sigurojne jetegjatesi te proceseve ekologjike te ketij vendepozitimi si dhe perkujdesje e metejshme dhe mbrojtjen e siperfaqes nga kullotja e bagetive ne menyre qe te sigurohet rendimenti i zenies se ketij vegjetacioni te mbjelle.

Nje raport i vecante per zbatimin e masave rehabilituese duhet te dokumentohet ne dosjen perfundimtare te projektit.

Monitorimi i performances dhe qendrueshmerise pas rehabilitimit

Performance e depozitimit duhet te monitorohet per se paku nje vit te plote dhe duhet te nderrmeren masa korrigjuese nese eshte e nevojshme. Te dhenat per monitorimin duhet te mbahen periodikisht dhe nderhyrjet duhet te dokumentohen ne dosjen e projektit.

Objektivat e projektit te propozuar

Qellimi kryesor i projektit te propozuar eshte te identifikoj efektet e mundshme ne Mjedis, si dhe marrja e masave te domosdoshme per minimizimin dhe parandalimin e efekteve te krijuara ne mjedis nga zhvillimi i projektit “Vendepozitim dherash”. Rehabilitimi i zones

perreth aktivitetit, si dhe te lihen detyra dhe projekte per investitorin ne sherbim te komunitetit dhe me gjer.
Objektivat e shoqerise jane:
1- Pergatitja e sheshit (tokes)per vendepozitimin
2- Ndertimi i vendepozitimit
3- Sistemimi i shesheve dhe rrugeve te brendshme ne linje ne funksion te aktivitetit qe do te zhvillohet.

Objektivat e hartimit te VNM- se konsistojne ne evidentimin dhe reduktimin e ndikimeve ne mjedis dhe masat tekniko-organizative per nje zhvillim te qendrueshem te mjedisit, gjate kryerjes se aktivitetit deri ne perfundim te tij, rehabilitimin e hapesires se shfrytezuar per nje mjedis te qendrueshem ne vitet pas ardhese.
i percaktuar me fjale te thjeshta, VNM eshte nje proces sistematik per te percaktuar dhe vleresuar efektet apo ndikimet ne mjedis te nje veprimi apo projekti te caktuar. Ne nje situate normale, ky proces aplikohet perpara se te merren vendimet dhe te fillojne angazhimet per realizimin e projektit. Po sidoqofte, dhe ne çdo kohe, efektet sociale, kulturore dhe shendetesore jane konsideruar si pjese integrale e VNM. Kujdes i veçante i kushtohet praktikave te VNM per te parandaluar dhe minimizuar efektet e mundshme negative te veprimeve te ndermarra.

Qellimi i VNM eshte te:

- Te jape informacion per vendimmarresit per pasojat mjedisore te veprimeve te propozuara;
- Te promovoje zhvillimin miqesor dhe te qendrueshem me mjedisin duke identifikuar masat e duhura per permiresimin dhe zvogelimin e ndikimeve ne mjedis.

Zhvillimi i Qendrueshem eshte nje koncept kyç qe ka marre nje perhapje dhe pranim nderkombetar gjate dy dekadave te fundit. Agjenda 21, dhe plani global per zhvillimin e qendrueshem, theksojne rendesine e vendimarrjes se integruar te mjedisit dhe te zhvillimit, si dhe promiovimin e VNM dhe instrumenteve dhe politikave te tjera per kete qellim.

- *Rendesia e VNM*

Reduktimi i ndikimeve ne mjeds arrihet nese nje zhvillim behet i qendrueshem me mjedisin. Keto ndikime jane mjaft komplekse, me te medha ne shkalle dhe per me teper shtrijne pasojat e tyre me shume se 10 vjet me pare ku u fut koncepti i VNM ne vendin tone. Si rezultat, VNM eshte kthyer ne nje vegel kyç per vendimarrjen ne nje zhvillim te propozuar.Ne aspektin nderkombetar, roli i VNM eshte njohur ne Principin e 17 te Deklarates per mjedisin dhe Zhvillimin. VNM, si nje instrument kombetar duhet te aplikohet per aktivitetet e propozuara te cilat pritet qe te kene ndikim negativ ne mjedis dhe jane subjekt i nje vendimmarrje te nje autoriteti kombetar.

- *Qellimet dhe objektivat e VNM*

VNM-ja eshte nje proces qe ka si qellim kryesor identifikimin e pasojave ne mjedis, sociale dhe ekonomike te nje projekti para vendimarrjes per zbatimin e tij. Nepermjet VNM realizohet mbrojtja e mjedisit qysh ne fazen e hartimit ose dizenjimit te projektit, gjenden rruge ose menyra per te zvogeluar ndikimet negative, propozohen alternative ose zgjidhje te tjera per vendimmarresit. Qellimi dhe objektivat e VNM mund te ndahen ne dy kategori.

Qellimi i pare, drejtperdrejte, eshte te informoje procesin e vendimarrjes duke identifikuar si te konsiderueshme e potenciale ne mjedis dhe rreziqet e perfitimet e projektit dhe zhvillimit te propozuar.

Qellimi perfundimtar, afatgjate i VNM eshte te promovoje zhvillimin e qendrueshem duke siguruar qe propozimet e projektit nuk minojne burimet natyrore dhe funksionet ekologjike ose mireqenien, stilin e jetes dhe jetesen e komunitetit si dhe te njerezeve qe lidhen apo varen nga ky projekt ose aktivitet.

Objektivat afatshkurter dhe te drejtperdrejte te VNM:

- Permiresim nga pikepamja mjedisore i propozimit dhe projektit;
- Siguron qe burimet natyrore jane perdorur ne menyren e duhur dhe me efiçence;
- Identifikon masat e duhura per zvogelimin e ndikimeve te mundshme potenciale te projektt apo propozimit; dhe
- Lehteson informimin e vendimmarresit, duke perfshire vendosjene termave dhe kushteve mjedisore per zbatimin e projketit apo propozimit.

Objektivat afatgjate te VNM jane:

- Siguron dhe mbron shendetin e njeriut;
- Parashikon dhe perjashton ndryshimet e pakthyeshme dhe demtimet serioze te mjedisit;
- Ruan dhe mbron burimet natyrore, pesiazhet e natyres dhe komponentet perberes te ekosistemeve; dhe
- Permireson aspektet sociale te projektit

VNM-ja eshte ne funksion te mbrojtjes se mjedisit dhe favorizon zhvillimin e qendrueshem, integrin mbrojtjen e mjedisit me marrjen e vendimeve qe ne fazat e hershme te planifikimit te aktiviteteve, mbron mjedisin dhe shmang pasojat sociale, ekonomike, kulturore dhe parashikon masat permiresuese per zbutjen e tyre ne rast te zhvillimit te nje aktiviteti, merr ne konsiderate perfshirjen e publikut, agjensive ose shoqatave ne vendimarrjen per zhvillimin e aktivitetit.

VNM-ja mund te coje ne reduktimin e kostos dhe kohes per zbatimin e projektit dhe ne permiresime te ligjeve dhe rregulloreve. Procesi i VNM mund te arrije ne tre perfundime te mundeshme:

1. *Nuk ka efekte negative te projektit ose efektet jane te njohura por ndikimi nuk eshte sinjikativ*
2. *Efektet mjedisore nuk mund te njihen qe ne fazen e hartimit te projektit*
3. *Efektet e pritshme jane te konsiderueshme dhe sinjifkative ndaj duhet bere rishikimi i projektit.*

Legjislacioni kryesor shqiptar per mjedisin, evolucioni i tij
Ministria e Mjedisit (MM)

Per here te pare, ne vitin 2001 u krijua ne shqiperi Ministria e Mjedisit. Historiku i institucioneve ne mbrojtje te mjedisit fillon ne vitin 1991, kur brenda Ministrise se Shendetesise u krijua Komiteti per Ruajtjen dhe Mbrojtjen e Mjedisit. Ne vitin 1998, Parlamenti Shqiptar miratoi Ligjin Nr.8364, 02.07.1998 "Per mjedisin", ligj i cili transformoi Agjencine Kombetare te Mjedisit ne institucion te pavarur i cili ishte ne varesi direkte dhe raportonte tek Kryeministri. Krijimi i Ministrise se Mjedisit ne vitin 2001 vazhdoi perpjekjet dhe tendencen per t'i dhene rendesine e duhur autoriteteve te mbrojtjes se mjedisit. Ne vitin 2005, Ministria e Mjedisit, ndryshoi emertimin ne Ministria e Mjedisit, duke marre keshtu edhe me shume kompetenca ne pasuri te tjera natyrore te vendit si ujrat, pyjet dhe peshkimi. Pozicioni, dhe kompetencat e reja te autoriteteve te mjedisit brenda qeverise, krijojne mundesi per te ndermarre me shume veprime dhe nisma ambicioze per te forcuar kapacitetet administrative dhe per te ngritur institucionet e duhura pergjegjese per menaxhimin e mjedisit.

Autoritete te tjera ne nivel qendror qe lidhen me mjedisin

Komisioni Parlamentar per Shendetesine dhe Mjedisin, punon per Parlamentin dhe rishikon draft-ligjet e pregatitura nga MM, aprovon marreveshjet nderkombetare dhe organizon dhe aprovon debatet per çeshtjet e mjedisit. Ka dhe nje numer te caktuar Ministrish dhe institucionesh te tjera shteterore qe kane marre dhe marrin masa te rendesishme per mbrojtjen dhe menaxhimin e mjedisit. Disa nga keto ministri kane krijuar departamente dhe njesi perkatese pergjegjese per mjedisin ne sektorin qe te mbulojne.

Ne nivel rajonal dhe lokal

Ne nivel rajonal, pergjegjese per mjedisin jane Agjencite Rajonale te Mjedisit (ARM), te cilat jane strukture e MM. Ne vendin tone jane 12 ARM te organizuara ne nivel Prefekture. Ne nivel lokal, njesite e qeverisjes vendore Bashkite, jane pergjegjese per mbrojtjen e mjedisit, megjithse ne pergjithesi ato nuk kane staf te specializuar per problemet e mjedisit. Bejne perjashtim ketu Bashkite e nivelit te pare Bashkia Tirane, Durres, etj.

Legjislacini i VNM-se

Ligji pare per mjedisin eshte ai me Nr.7664, date 21 Janar 1993, i cili e permend VNM por nuk qarteson asnje procedure per kryerjen e saj.

Ligji dyte ne serine e legjislacionit mjedisor eshte ai me Nr.8364, date 02.07.1998 "Per mjedisin", i cili serisht e ka kete difekt per VNM.
Duhet theksuar se vendi yne ka edhe legjislacionin e tij mjedisor te hartuar keto vitet e fundit, sidomos pas vitit 2002 kur edhe ka filluar plotësimi i kuadrit legjislativ ne fushen e mjedisit. Ky kuadër legjislativ permbledh te gjitha llojet e akteve legjislative duke filluar nga Kushtetuta e Republikes se Shqiperise, ligje te përgjithshme per mjedisin dhe per perberes te veçante te tij, vendime te këshillit te ministrave, urdhra dhe udhëzime te ministrive, rregullore specifike, norma e standarde, etj. Ky legjislacion eshte i përfaqesur me standartet e Bashkimit Europian sepse mbeshtetet ne te njëjtat parime qe eshte mbështetur legjislacioni mjedisor evropian, por gjithashtu eshte hartuar me asistencen e eksperteve te huaj duke respektuar keshtu edhe konventat nderkombetare ku shteti shqiptar eshte pale.

Kuadri aktual ligjor per VNM eshte parashikuar ne:
- Ligji Nr.10 431, datë 9.6.2011 "Për mbrojtjen e Mjedisit"
- Ligji Nr. 10 440 datë 07.07.2011, "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis"

Direktivat kryesore ne te cilat janë mbështetur bazat kryesore ligjore janë:
- Direktiven 85/337/EEC te Keshillit te Europes
- Direktiven 2001/42/EC E te Parlamentit Europian dhe Keshillit te Europes
- Direktiven 2004/35/CE te Parlamentit Europian dhe Keshillit te Europes

Megjithate, legjislacioni mjedisor vazhdon te jete ne nje proces intensiv plotësimesh e permiresimesh per t'u pershatatur me standardet dhe normat me te mira mjedisore dhe per te siguruar nje zhvillimi te qendrueshem te ekonomise se vendit.

Permbledhje te përgjithshme te karakteristikave te VNM-se

Qellim	**VNM**
Procesi i vleresimit	Vlerësimi ---> Raporti ---> Miratimi ---> Monitorimi
Shkalla e vleresimit	E krahasueshme me ndikimet potenciale
Mbulon fushat	Mjedisore, Social-ekonomike, të trashëgimisë kulturore, etj
Konsideron	Politikën Mjedisore, Institucionale dhe Monitoruese
Niveli	I detajuar për një projekt
Procedura e raportit	Shtojca 1 – Projektet qe i nënshtrohen Procedures se Thelluar te Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis Shtojca 2 – Projektet qe i nënshtrohen Procedures Paraprake te Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis
Baza ligjore	Ne përmirësim te vazhduar
Mbeshtetur	Legjislacioni Shqiptar, Direktivat e EU (si Direktiva 87/11/EC) Praktikat internacionale (si udhezuesit e Bankes Boterore OP 4.01).
Adreson	Çështje të projektit specifik

Klasifikimi i aktivitetit sipas ligjeve baze

Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis (VNM) i veprimtarive ndertuese dhe prodhuese Ligji Nr.10 431, datë 9.6.2011 "Për mbrojtjen e Mjedisit"

Ligji Nr. 10 440 datë 07.07.2011, "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis" përcakton detyrimet per Pajisjen me Leje Mjedisore te subjekteve fizike dhe juridike qe kerkojne te ushtrojne nje veprimtari qe ka ndikime ne mjedis.

Ligji Nr. 10 440 datë 07.07.2011, "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis"Kreu II, Neni 7, shprehet:

1- Procesit te vleresimit te ndikimit ne mjedis i nenshtrohen te gjitha projektet dhe veprimtaritet qe jepen ne shtojcat 1 dhe 2 te ketij ligji, perpara miratimit te tyre nga organet perkatese.
2- Projektet dhe veprimtarite i nenshtrohen dy niveleve te shqyrtimit per vleresimin e ketij ndikimi:

- *Raport i thelluar i vleresimit te ndikimit ne mjedis*
- *Raport paraprak i vleresimit te ndikimit ne mjedis*

Si dhe mbeshtetur ne Vendimin Nr.805, dt 04.12.2003 "Per miratimin e listes se veprimtarive, qe ndikojne ne mjedis, per te cilat kerkohet Leje Mjedisore".

Ligji mbi Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis (VNM) percakton nivelin e shqyrtimit per vleresimin e ndikimit ne mjedis te projekteve apo veprimtarive qe kerkojne operojne ne territorin e Republikes se Shqiperise para implementimit. Dy nivelet e shqyrtimit te VNM-ve jane:
Kerkesat e studimit te Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis

Mbeshtetur nga informacioni ne lidhje me karakteristikat e projektit, vendndodhjen e projektit (te dhena per mjedisin, banoret dhe kulturen) dhe impaktin potenciale te projektit, informacion i cili do te perdoret nga MM dhe do te percaktoje nevojen per nje VNM te Permbledhur apo te thelluar.

KAPITULLI III

PERSHKRIMI I VENDIT KU DO ZHVILLOHET AKTIVITETI

3.1 Karakteristikat e zones (Mjedisi fizik)

3.1.1 Gjeologjia

Raoni ne te cilin gjendet zona e propozuar per zhvillimin e ketij aktiviteti ben pjese ne zonen tektonike te Krujes dhe Brenda saj ne vargun e strukturave antiklinale Kruje-Dajt-Gryka e Erzenit, qe vazhdon edh me ne Jug duke formuar krahun lindor te tyre i cili bie drejt lindjes me kende 30 deri 35 grade.
Ne ndertimin litologjik te rajinit marrin pjese depozitimet e pjese se poshtme qe perfaqesohet nga nje vazhdimesi karbonatike dhe ato te pjese se siperme te perfaqesuara nga material copezore, terrigjene dhe shtresa e pako flishore e flishoidale. Si kufi ndares ndermjet ketyre dy lloj formacionesh eshte pako mergelore kalimtare.

Mbi pakon mergelore kalimtare vendoset prerja flishore-flishoidale qe ndertohet nga nje vazhdimesi shtresash terrigjene e copezore te cilat poshte kane karakter flishor kurse me larte kane karakter flishoidal. Zona e ndertimit vendoset mbi depozitat e Tortonianit perfaqesuar nga mollose, argjila alevroilite, ranore,me shtresa dhe reshpe qymyrore.



Harta gjeologjike e zones

Tektonika

Karakteristike per rajonin ne studim jane levizjet neotektonike ngritese, itensiteti i ulet i te cilave perben shkakun kryesor te rilievit kodrinor.

3.1.2 Pershkrimi gjeologo-morfologjik i zones

E gjithe zona karakterizohet nga rilievi fushoro-kodrinor, ku bie ne sy shkalla e larte e copezimit horizontal, shkalla e vogel deri ne te mesme e copezimit vertical dhe pjerresia mesatare e shpateve. Drejtimi kryesor i vargjeve kodrinore eshte juglindje-veriperendim.
Forma karakteristike e rilievit qe shfaqet ne rajon eshte ajo strukturoro-erozive, qe perfaqesohet nga kreshtat monoklinale dhe kuestet.

3.1.3 Hidrologjia

Zona pershkohet nga nje rrjet i dendur perrenjesh nder te cilet me i madhi eshte perroi i Farkes. Ne kufirin veriperendimor te sheshit rrjedh perroi i Kabellit, i cili ashtu si edhe perrenjte e tjere te zones derdhet ne Lumin Erzen. Keta perrenj dallohen per regjim te crregullt te rrjedhjes, qe lidhet me karakterin e regjimit te reshjeve, me vecorite topografike te pellgut ujembledhes, me perberje prej formacionesh terrigjene te papershkueshem etj. Ata

kane karakterin e perrenjeve me rrjedhje te perkoheshme, qe shpesh marrin formen e rrjedhjeve baltore. Karakteri i perkohshem i ben at ate rrezikshem, sepse me erozionin jashtezakonisht te madh zhdukin me shpejtesi bimesine dhe mbulesen e tokave, duke u degraduar ate vazhdimisht deri ne dezertifikimin e plote te saj. Sa i takon ujerave nentokesore, ne zonen ne studim ata gjenden ne thellesi me te medha se 20 m. mineralizimi i ujerave pritet te jete i tipit hidrokarbonat magnezial i perdorshem per tu pire, me vlere maksimale te pH 5.8-7.2.



Harta hidrologjike e zones

Lumi Erzen

Lumi Erzen shtrihet nga zona e Gurakuqit me nje lartesi 1300 m mbi nivelin e detit deri ne detin Adriatik ne Gjirin e Lalzit prane Durresit.

Pamje e basenit te Lumit Erzen

Pellgu i lumit Erzen mbulon nje siperfaqe prej 760 km^2, me nje gjatesi te pergjitheshme te linjes kryesore rreth 110 km dhe nje lartesi mesatare te pellgut ne rreth 440 m mbi nivelin e detit. Ne menyre konvecionale lumi Erzen klasifikohet zakonisht se bashku me lumin Ishem ne ne te njejtin pellg, qe eshte nje nga gjashte ujembledhesat kryesore te lumenjeve te Shqiperise. Pjerresia mesatare e shtratit te lumit eshte rreth 0.6 % ndersa pjerresia mesatare e bankinave te lumit eshte rreth 2.6 %. Lumi Erzen ne pjesen e siperme ka karakteristikat e nje lumi malor me intesitet me te larte te rrjedhes, ndersa pas ngushtices Skorana lumi kalon ne nje zone kodrinore dhe fushore deri ne derdhjen e saj ne det. Ne pjesen e siperme te Erzenit, ku ka nje reliev te pjerret shtrati i lumit eshte i ngushte dhe me nje pjerresi te madhe te lumit. Diametrat e gureve te lumit arrin 1 m dhe me shume. Pas kryqezimit me degen e pare malore ne lumin Erzen, diametri i gureve reduktohet ne 20-30 cm. Pas kalimit te ngushtices Skorana, guret lumore kane diametra nga 60-10 cm dhe depozitimet ranore behen evidente. Regjimi lumor i ujit eshte tipike mesdhetare, karakterizuar nga nje regjim shume i ndryshueshem me derdhje maksimale ne dimer dhe ne vere minimale. Si vecori e pergjitheshme do te veconim vleren e shkarkumit kryesor vjetor te pjeses se poshtme te lumit Erzen, qe eshte rreth 15-20 m^3/sek ne Sallmonaj (1966), ndersa minimalja mund te jete me e ulet se 1 m^3/sek. Ujerat e lumit Erzen jane me mineralizim te ulet, te tipit bikarbonat-kalcium. Mineralizimi mesatare i pergjithshem i lumit Erzen eshte rreth 300-500 mg/l.

Te dhena te pergjitheshme per burimet ujore ne rajonin e Tiranes dhe Erzenit

Rajoni i Tiranes

Ne kete rajon jane te njohur 34 burime, 3 ne aquifer Pliocene, 12 ne ujembajtesin e Tortonian ne horizontin me te ulet ranore, 14 ne ujembajtesin Tortonian ne horizontin me te larte ranor dhe 5 burime jane jashte tyre. Prurja mesatare e burimeve ne kete zone eshte shume e vogel, ajo lekundet prej 0.01l/sek ne 0.64 l/sek: 0.05-0.15 l/sek ne ujembajtesin e Pliocene, 0.05-0.64 l/sek ne ujembajtesin e Tortonian ne horizontin me te ulet ranor dhe jashte tyre 0.01-0.20 l/sek. Burimet e vetme qe i perkasin ketij rajoni te monitoruara ne kuader te matjeve ne

terren te kryera gjate periudhes Nentor 2009-Mars 2010 eshte: -Burimi Gurre, ne ujembajtesin e Tortonianit ne horizontin me te ulet ranore me nje prurje mesatare prej 0.64 l/sek.

Rajoni Erzenit

Brenda ketij rajoni jane te njohur 11 burime, 1 ne ujembajtesin Pliocene, 9 ne ujembajtesin Tortonian ne horizontin me te ulet ranore dhe 1 jashte tij. Prurjet mesatare te burimeve jane shume te vogla, ato lekunden prej 0.10 l/sek ne 0.40 l/sek: 0.30 l/sek ne ujembajtesin Pliocene dhe 0.10-0.40 l/sek ne ujembajtesin Tortonian ne horizontin me te ulet ranore. I vetmi burim i monitoruar qe eshte pjese e ketij rajoni me matjet e thjeshta te kryera ne terren gjate periudhes Nentor 2009- Mars 2010 eshte : - Burimi i Gerblleshit ne ujembajtesin e Tortonian ne horizontin me te poshtem ranor me nje prurje mesatare prej 0.40 l/sek.

Ne rajonet e Tiranes dhe Erzenit, burimet praktikisht mungojne pak burime karakterizohen nga vlera te prurjeve shume te vogla < 1 l/sek.

Klasifikimi cilesor i ujerave nentokesore sipas parametrave baze

	Unità di misura	Classe 1	Classe 2	Classe 3	Classe 4
Conducibilità elettrica	µS/cm(20°C)	≤400	≤2500	<2500	>2500
Cloruri	mg/L	≤ 25	≤ 250	≤250	>250
Manganese	µg/L	≤ 20	≤ 50	≤50	>50
Ferro	µg/L	<50	<200	≤ 200	>200
Nitrati	mg/L di NO_3	≤ 5	≤ 25	≤50	> 50
Solfati	mg/L di SO_4	≤ 25	≤ 250	≤250	>250
Ione ammonio	mg/L di NH_4	≤ 0,05	≤ 0.5	≤0.5	>0.5

3.1.4 Tokat

Karakteristike per zonen ku propozohet te ndertohet vendepozitimi jane tokae e hirta kafe, formimi i te cilave kushtezohet nga klima mesdhetare kodrinore qe karakterizon zonen dhe shkembinjte terrigjen qe e perbejne ate. Karakteristike e pergjithshme e ketyre tokave eshte ngjyra e hirte kafe, perberja mekanike me e rende ne Horizontin B, reaksioni neutral dhe lehtesisht bazik. Keto jane toka minerale, me shkalle te ndryshme te diferencimit te profilit dhe prirje argjilizimi ne shtresen e mesme te tij. Formula e profilit te tokave te hirta kafe eshte A1-A2-Ab-BC-C ose A-AC-C. Ato kane permbajtje mesatare humusi dhe azati ne horizontin A, te varfra me fosfor P, te pasura me kalium K dhe $CaCO_3$, si dhe te sturuara me baza. Keto toka kane pergjithesisht cilesi dhe strukture fizike te mire per shkak te permbajtjes se humusit, $CaCO_3$ dhe bazave ne komplekesim thithes.



Harta e tokave

3.1.5 Klima

Rajoni ne studim perfshihet ne zonen e klimes mesdhetare kodrinore e cila karakterizohet nga dimri i bute dhe teper i laget dhe vera e nxehte dhe teper e thate, me konkretisht ne nen zonen mesdhetare kodrinore qendrore. Vecarite klimatike te zones jane kushtezuar kryesisht nga afersia dhe hapja e saj ne drejtim te detit adriatik por edhe nga lartesia e vogel e relievit dhe ngritja graduale e tij nga perendimi ne lindje. Temperatura e ajrit merr vlera qe ndryshojne nga sektoret e ulet ne sektoret e larte si dhe gjate stineve te vitit. Temperatura mesatare vjetore eshte 15-16 ^{o}C. Temperatura mesatare e janarit i cili eshte dhe muaji me i ftohte luhatet ne vlera nga 4 -6 ^{o}C, ndersa temperaturat e korrikut qe eshte dhe muaji me i nxehte i vitit luhaten ndermjet vlerave 24-25 ^{o}C. Vlerat skajore te temperatures luhaten ne kufij mjafte te medhenj, nga -3.5 ^{o}C qe eshte minimumi absolut ne 38 ^{o}C. Ne rajonin ne studim takohen rreth 260 dite me temperature te barabarte apo me te larte se 10 ^{o}C, 140 dite me temperature te barabarte apo me te larte se 15 ^{o}C dhe 114 dite me temperature te barabarte ose me te larte se 20 ^{o}C. Ne periudhen dhjetor-shkurt mund te shfaqen ngricat, qe zakonisht zgjasin pak rrallher gjate gjithe dites. Zona dallohet per vlera te larta te diellezimit shuma vjetore e oreve me diell eshte 2600 ore. Ne janar kjo shume mberrin ne 125 ore ndersa ne korrik shkon rreth 350 ore.

3.1.6 Rreshjet

Rreshjet perqendrohen kryesisht ne gjysmen e ftohte te vitit gjate te cilit bie rreth 68 % e sasise vjetore, ndersa 32 % bien ne stinen e ngrohte. Nga te dhenat e institutit Hidrometeorologjise rezulton se sasia mesatare vjetore e reshjeve ndryshon nga 1241 mm ne

1354 mm, e dila eshte me e vogel se mesatarja e gjithe vendit. Cdo vit takohen mesatarisht 120-130 dite me rreshje, shperndarja vjetore e te cilave eshte e crregullt tipike kjo per regjimin mesdhetar. Muaji me i thate eshte korriku, gjate te cilit bien 33 mm reshje qe perbejne vetem 2.4 % te sasise vjetore, ndersa muaji me i lagesht eshte nentori me 14% te reshjeve vjetore. Reshjet ne formen e bores jane te rralla dhe trashesia e saj eshte e vogel, vetem disa centimetra. Rezultatet kryesore te reshjeve sezonale jane vere e thate dhe dimer i lagesht. Zona dallohet per vlera te larta te diellezimit shume vjetore me ndricim diellor mberrin ne 2600 ore. Ne janar kjo shume mberrin ne 125 ore ndersa ne korrik shkon rreth 350 ore. Eshte i rendesishem fakti i njohjes se tabelave te rreshjeve ne kete zone per te pare me mire ekspozimin e ketij relievi. Ne Tirane mbizoteron nje klime nentropikale-mesdhetare me reshje dimerore dhe me temperatura mesatare vjetore ne korrik + 24 ^{o}C dhe ne janar +7 ^{o}C. Ne vit bie 1189 mm shi.



Burimi BBC Weather Service

3.1.7 Era

Edhe regjimi i eres lidhet ngushte me relievin dhe afersine me detin. Drejtimet e ereva gjate vitit jane mjafte te ndrysheme, megjithate mbizoterojne ererat lindore dhe juglindore.

3.1.8 Flora dhe habitati i zones

Zona ne studim ben pjese ne habitatin e mozaikut buqesor, makies dhe pyjeve breglumore. Zona gjendet me kendrejtim jugor me pjerresi 10 %, dhe mbulese bimore 60 % shkurre dhe bimesi barishtore 40 %. Zona e mozaikut bujqesor eshte e kultivuar me eil (Medicago sativa) dhe shoqeruar me bimesi te aravea si : Grashine (Vicia lathyroides), Lepjeta (Rumex acetosa), Rrodhja (arctium lappa), Cikorja e eger (Cichorium intybus), Potentille zvarritese

